

Sinjalizime

Ekskluzive | Të shtëna me kallashnikov në aheng familjar në Prizren – dy persona në pranga, Policia sekuestron armët



Sinjali.com

22 Korrik 2026 09:46



Një aheng familjar në fshatin Gjonaj të Prizrenit ka përfunduar me arrestimin e dy personave, pasi Policia ndërhyri pas raportimeve për të shtëna me armë zjarri, raporton Sinjali.

Sinjali mëson ekskluzivisht se të dyshuarit janë Arlind Jahaj rreth 34 vjeç dhe Jeton Krasniqi rreth 47 vjeç.

Sipas burimeve të Sinjalit, pas pranimit të informacionit për të shtëna me armë gjatë ahengut, në vendin e ngjarjes kanë dalë patrullat policore, mbikëqyrësi i ndërrimit, hetuesi kujdestar dhe njësia e krimteknikës.

Gjatë ndërhyrjes, Policia ka identifikuar dy të dyshuarit, të cilët kanë dorëzuar një armë me gaz së bashku me një karikator.

Megjithatë, ekzaminimi i vendit të ngjarjes ka zbuluar edhe 21 gëzhoja të armës me gaz dhe 7 gëzhoja të armës së zjarrit, të cilat dyshohet se i përkasin një kallashnikov.

Gjatë kontrollit të automjetit të të dyshuarve, Policia ka gjetur dhe sekuestruar edhe kallashnikovin, një karikator dhe 20 fishekë, të cilët janë marrë si prova materiale.

Të dy të dyshuarit janë shoqëruar në stacionin policor, ku janë intervistuar në prani të procedurave ligjore.

Me vendim të Prokurorit të Shtetit, ndaj tyre është iniciuar procedurë për veprat penale *"Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm"* dhe *"Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve"*, ndërsa të dy janë dërguar në ndalim policor për 48 orë.

Rasti është duke u hetuar nga organet kompetente.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Aheng

Armë

Policia


Të shtëna

Të tjera:



Policia e konfirmon për Sinjalin se polici 35-vjeçar dyshohet se ka kryer vetëvrasje

Siguri



Plagosje, përleshje dhe të shtëna me armë zjarri, policia arreston dy persona në Pejë

Siguri



Policia kërkon ndihmë nga qytetarët për kapjen e të dyshuarit për vjedhje

Siguri




Ekskluzive | Ky është i dyshuari që u paraqit pas dy javësh në arrati – Policia i kishte gjetur ...

Sinjalizime



Ekskluzive | Aksion i madh kundër evazionit fiskal në Prizren e Suharekë – zbulohen...

Sinjalizime




Ekskluzive | Ky është zyrtari i arrestuar për lejimin e importit të kimikateve të ndaluara...

Sinjalizime



Gruaja e denoncoi për dhunë, Policia i gjen kallashnikov në shtëpi – 65-vjeçari procedohet...

Sinjalizime



Ekskluzive | Policia ia konfiskoi veturën, 35-vjeçari kërcënon dhe fyen dy zyrtarë policor...

Sinjalizime

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtimi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera